



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

Up1 Nr.08-424

26.11.2021

Shkup

Në pajtim me nenin 18, paragrafi 1, nëparagrafi 2, nenin 82, paragrafi 1, nënparagrafi 5 dhe nenin 83 të Ligji i Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare Maqedonisë “, 6p.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 и 27/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.42/20 dhe 77/21), e në lidhje me nenin 62, paragrafi 6, të këtij ligji, nenin 9 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapsinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për emetim të radios ose të televizionit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.172/14 dhe 76/15), nenin 51, paragrafi 1 dhe paragrafi 3 dhe nenin 52, paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.124/15), nenin 28 të Ligjit të Kontesteve Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr.96/19), duke vepruar sipas propozimit Up1 nr.08-424 nga 12.11.2021, për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë tregtare radiodifuzive TV NOVA SHPK Gjevgjeli dhe propozimi Up1 nr.08-424 nga 24.11.2021 për miratimin e vendimit për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë tregtare radiodifuzive TV NOVA SHPK Gjevgjeli, dhe në përputhje me konkluzionin, nr.02-4259/2 nga 26.11.2021, këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, më 34-të seanca e mbajtur më 26.11.2021 miratoi:

VENDIM

për marrjen e lejes për emetim televiziv të Shoqërisë tregtare radiodifuzive TV NOVA SHPK Gjevgjeli

1. I MERET leja për emtim televiziv, nr.08-43 nga 05.01.2015 të Shoqërisë tregtare radiodifuzive TV NOVA SHPK Gjevgjeli, sepse pas dhënie së lejes u krijuan rrethana që përbëjnë pengesa ligjore që poseduesi i lejes të kryejë veprimtarinë, sepse transmetuesi nuk i plotësonte kërkesat minimale të personelit të përcaktuara në Rregullore për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kushtet të kuadrit për marrjen e lejes për radio dhe emetim televiziv.

2. Ky vendimi publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ueb faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e komunitetit joshumicë, por që flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim është përfundimtar.

A r s y e t i m

Shoqëria tregtare radiodifuzive (SHTR) TV NOVA SHPK Gjevgjeli, është posedues i lejes për emtim televiziv, nr.08-43 nga 5.1.2015, për transmetim nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit që nuk përdor burim të kufizuar, në nivel lokal (komuna e Gjevgjelisë, komuna e Vallandovës, komuna e Bogdancit dhe komuna e Dojranit), shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me nenin 62, paragrafi të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAV), për të ofruar emetim televiziv ose radio përveç kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, transmetuesi duhet të plotësojë minimume të

veçanta teknike, hapsinore, financiare dhe kushtet të kuadrit në varësi të formatit programor, të përcaktuara me akt nënligjor të miratuar nga Agjencia.

Në nenin 22 paragrafi 6 i Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kushtet të kuadrit për marrjen e lejes për emetim radioteleviziv, parashikon që numri dhe struktura e të punësuarëve për televizion në nivel lokal, duhet të jetë së paku 5 (pesë) persona, nga të cilët 3 (tre) persona me arsim të lartë, të punësuar si gazetarë

Në pajtim me nenin 82 paragrafi 1, nënparagrafi 5 të të njejtë ligj, Agjencia ia heq lejen për emetim televiziv ose radio para kalimit të afatit për të cilin është lëshuar dhe e fshin transmetuesin nga regjistri i transmetuesve, pas dorëzimit paraprak me shkrim të njoftimit nëse pas dhënies së lejes lindin rrethana që përbëjnë pengesë ligjore për kryerjen e veprimtarisë nga mbajtësi i lejes.

Në pajtim me nenin 27, paragrafi 1 të LSHMAV, Agjencia kryen mbikëqyrje administrative, e cila kryhet në punën e botuesve të mediave në aspektin e pajtueshmërisë së punës së tyre me kushtet e përcaktuara me Ligjin e Mediave, Ligjin e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij (neni 29 paragrafi 1 të LSHMAV).

Në pajtim me nenin 27, paragrafi 4 të LSHMAV, Agjencia kryen mbikëqyrje të jashtëzakonshme, në bazë të iniciativës së paraqitur nga organet shtetërore, persona juridikë ose fizikë, si dhe në rast dyshimi sipas detyrës zyrtare të Agjencisë.

Më datë 14.09.2021, Agjencia ka dërguar shkresë te KTR TV NOVA SHPK Gjevgjeli (ark.nr.03-3373/1), duke kërkuar nga transmetuesi që të dorëzojë dokumentet brenda shtatë ditëve nga pranimi i shkresës të paraqesë dokumente nga të cilat mund të konstatohet se i plotëson kushtet minimale të kuadrit të përcaktuara me Rregullore për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për emetim radio dhe televizion, gjegjësisht se ka angazhuar të paktën pesë persona, tre prej të cilëve me arsim të lartë të punësuar si gazetarë.

Meqë transmetuesi nuk ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm brenda afatit të caktuar, Agjencia edhe njëherë me shkrim u drejtua te transmetuesi (Shkresë ark.nr. 03-3373/2 nga 25.10.2021) me çka i është theksuar se duhet të dorëzojë në mënyrë të rregullt të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Afati për dorëzimin e dokumentacionit ka kaluar më 2.11.2021, por përfudimisht më 9.11.2021 (kur është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme sipas detyrës zyrtare nga ana e Agjencisë), transmetuesi nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion.

Rrjedhimisht, ashtu sikurse më sipër, Agjencia, nëpërmjet Sektorit të planifikimit strategjik dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit, kreu mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative sipas detyrës zyrtare për punën të KTR-së TV NOVA SHPK Gjevgjeli, ku në raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-4127/1 nga 9.11.2021, konstatoi se KTR TV NOVA SHPK Gjevgjeli, nuk i plotëson kërkesat minimale të kuadrit të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapsinore, financiare dhe kushtet të kuadrit për marrjen e lejes për radio dhe emetim televiziv.

Duke marrë parasysh shkeljen e konstatuar të nenit 62, paragrafi 6 të LSHMAV-së dhe të nenit 22 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për radio emetim dhe emetim televiziv, dhe në pajtim me nenin 82 paragrafi 1 nënparagrafi 5 të ligjit të lartpërmendur, në raportin me shkrim për mbikëqyrjen administrative ark.nr.03-4127/1 nga 9.11.2021 u dha propozimmasë – kurse drejtori i Agjencisë të paraqesë propozim te Këshilli për fillimin e procedurës për heqjen e lejes për emetim televiziv të KTR-së TV NOVA SHPK Gjevgjeli, nr.08-43 nga 5.1.2015.

Në nenin 23, paragrafi 1, nënparagrafi 3 të LSHMAV-së nëse konstatohet se ka mosrrespektim, cenim ose shkelje të dispozitave të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të saj, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë, ndaj botuesit të medias, këshilli i Agjencisë mund të marrë masën – heqjen e lejes.

Në pajtim me nenin 82k paragrafi 1k nënparagrafi 5 të LSHMAV-së, Agjencia do t'ia heq lejen për emetim televiziv ose radio, para kalimit të afatit për të cilin është lëshuar dhe do ta fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve, me njoftimin me shkrim paraprakisht nëse pas dhënies së lejes ndodhin rrethana që përbëjnë pengesë ligjore për kryerjen e veprimtarisë nga poseduesi i lejes.

Procedurën për marrjen e lejes për emetim televiziv ose radio, në pajtim me nenin 83, paragrafi 1 të LSHMAV-së e inicion këshilli me propozimn e drejtorit të Agjencisë.

Duke marrë parasysh konstatimin e shkeljes së nenit 62, paragrafi 6 të LSHMAV-së dhe nenit 22 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për radio dhe emetim televiziv, drejtori i Agjencisë, në pajtim me nenin 83, paragrafi 1 të LSHMAV-së, dhe në lidhje me nenin 82 paragrafi 1, nënparagrafi 5 të këtij ligji, ka paraqitur propozim Up1 nr.08-424 nga 12.11.2021.për fillimin e procedurës për marrjen e lejes për emetim televiziv të KTR-së TV NOVA SHPK Gjevgjeli.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 33-të të mbajtur më 17.11.2021, në bazë të konkluzionit, ark.nr.02-4171/8 nga 17.11.2021, miratoi propozimin, Up1 nr.08-424 nga 12.11.2021, për fillimin e procedurës për marrjen e lejes për emetim televiziv të SHTR TV NOVASH PK Gjevgjeli, paraqitur nga propozuesi, drejtori i Agjencisë, dr Zoran Trajčevski.

Në lidhje me procedurën e nisur për marrjen e lejes së KTR-së TV NOVA SHPK Gjevgjeli, nr.08-43 nga 5.1.2015, dhe në pajtim me nenin 82, paragrafi 1, nënparagrafi 5 të LSHMAV-së, Agjencia i dërgoi njoftim transmetuesit në fjalë (Up nr.08-424 nga 19.11.2021), në të cilin i është theksuar se nëse nuk paraqet dokumentacionin e nevojshëm nga i cili mund të konstatohet se i plotëson kushtet minimale të kuadrit të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për radio dhe emetim televiziv, këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi i propozimit të drejtorit të Agjencisë, Up1 nr.08-424 nga 12.11.2021, do të marrë vendim për marrjen e lejes së tij për emetim televiziv, pas së cilës në pajtim me nenin 85, paragrafi 2 LSHMAV-së, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i transmetuesve.

Njoftimin Up1 nr.08-424 nga 19.11.2021, Agjencia ia dërgoi KTR-së TV NOVA SHPK Gjevgjeli më 19.11.2021, në formë të shkruar nëpërmjet postës së shpejtë EMS të postës së Maqedonisë, e cila në mënyrë të rregullt është pranuar nga transmetuesi më datë 22.11.2021. Gjithashtu, njoftimi i cituar më 22.11.2021.i është dërguar në formë elektronike në adresën elektronike të transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë Veriore, e cila është e regjistruar si adresë elektronike e transmetuesit në regjistrin e transmetuesve të Agjencisë.

Më datë 24.11.2021, nga sektori kompetent drejtorit të Agjencisë dr Zoran Trajčevski, i është dorëzuar njoftimi Up1 nr.08-424 nga 24.11.2021 se deri më 23.11.2021, nuk është dorëzuar dokumentacion në arkivin e Agjencisë nga ku mund të konstatohet se transmetuesi plotëson kushtet minimale të kuadrit të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për radioemetim dhe televizion.

Në pajtim me nenin 83, paragrafi 3 të LSHMAV-së, këshilli është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga pranimi i drejtorit të fillojë procedurën për marrjen e lejes, të miratojë vendim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

Duke marrë parasysh se poseduesi i lejes nr.08-43 nga 05.01.2015. – SHTR TV NOVA SHPK Gjevgjeli nuk e ka përmbushur obligimin e paraparë në nenin 62 paragrafi 6 të LSHMAV-së dhe nenin 22 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për radioemetim dhe televizion, dhe në përputhje me propozimi Up1 nr.08-424 nga __.11.2021 për miratimin e vendimit për

marrjen e lejes për emetim televiziv të KTR-së TV NOVA SHPK Gjevgjeli nga drejtori i Agjencisë dhe konkluzioni i Agjencisë , nr.08-424 nga 24.11.2021. u miratua vendimi për marrjen e lejes nr.08-43 nga 05.01.2015. për emetim televiziv të KTR-së TV NOVA SHPK Gjevgjeli, sepse pas dhënies së lejes janë paraqitur rrethana që paraqesin pengesë ligjore për poseduesin e lejes për kryejën e veprimtarisë, gjegjësisht për shkak se transmetuesi nuk i ka plotësuar kushtet minimale të kuadrit të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe të kuadrit për marrjen e lejes për radioemetim dhe televizion.

Në pajtim me nenin 84 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, vendimi për marrjen e lejes për emetim të radios ose të televizionit është përfundimtar, ndërkaq kundër kësaj pronari i lejes ka të drejtë që të parashtrojë padi te gjykata kompetente në afat prej 30 ditëve nga pranimi i saj. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lart të miratohet vendimi si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve
Mediatike Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit,
dv Lazo PETRUSHEVSKI**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi për marrjen e lejes, Shoqëria tregtare radiodifuzive TV NOVA SHPK Gjevgjeli ka të drejtë të ngre padi për ngritjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i tij.